



Secilit konsumator me rastin e vizitës do t'i gjenerohet (shtypet) fatura në të njejtën kohë për energjinë e shpenzuar, pos në raste të gabimeve apo shkaqeve tjera të mundshme teknike, mirëpo lexuesi është i obliguar që në afatin sa më të shkrutër, (jo më larg se 24 orë) ta rivizitojë konsumatorin dhe të bëjë të gjitha përmirësimet e nevojshme.

Faturimi bëhet sipas Sistemit Tarifor të aprovuar nga ZRrE.

038 501 701 100

038 791 000

contactcenter@keds-energy.com



Burimi i energjisë jeni ju.
Vi ste izvor energije.
The source of energy is you.



METODA MË MODERNE PËR LEXIM TË NJEHSORËVE

Përmes pajisjes së dorës për lexim të njëhsorëve



Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), është duke aplikuar teknologji të re për leximin e njëhsorëve për energjinë e shpenzuar

Metoda e re me teknologji të re nënkupton azhurnimet dhe korrektësi në të dhënat e regjistruara në pikat matëse (njehsori elektrik) të energjisë, si dhe informata për konsumatorin në kohë reale lidhur me shpenzimet e energjisë për secilin konsumator.

Metoda përfshin leximin me pajisjen e dorës (HHU), që minimizon çdo gabim eventual në lidhje me shpenzimin e energjisë elektrike gjatë leximit.

Leximi dhe faturimi me këto pajisje përfshin:

- Leximin e shpenzimit të energjisë elektrike nga pajisja e dorës (HHU), çdo muaj,
- Shtypjen dhe dorëzimin e faturës konsumatorit për shpenzimin e energjisë elektrike në momentin e leximit të energjisë nga pika matëse,
- Mundësinë e korigjimit aty për aty, në rast se vërtetohet gabimi në lexim,
- Informatat e menjëhershme të shërbimit për konsumatorë, aty për aty, nëse duhet intervenuar te pika matëse (njehsori elektrik) për arsye të parregullsive apo dëmtimeve eventuale të pikës matëse,
- Sistemi i ri mundëson mbikëqyrje në çdo moment të aktiviteteve të leximit në kohë reale.

Me fillimin e aplikimit të kësaj teknologjie do të ketë edhe ndryshime në kohën e leximit, si dhe ndryshime në dizajnin e faturës.

Leximi i njehsorëve duhet të përfshijë periudhën njëmuajore të shpenzimit të energjisë. Data e leximit të çdo konsumatori do të jetë e njëjtë sikurse e leximit paraprak, me maksimum +/- dy ditë pune. Në rast se data e leximit dhe toleranca e lejuar dy ditë i bie të jetë në fund të javës ose gjatë festave shtetërore, atëherë periudha kohore e shpenzimit të energjisë elektrike mund të shkurtrohet ose të zgjatet për aq sa zgjasin këto festa.

Nëse konsumatori nuk mund të ketë qasje në leximin e pikës matëse (njehsori elektrik) që gjendet në objekt të konsumatorit, për dy muaj me radhë të ciklit të leximit dhe faturimit, lexuesi duhet të raportojë për shkyçjen e këtyre konsumatorëve nga rrjeti elektrik për shkak të pamundësisë së leximit.

Fatura e re e energjisë elektrike përmban informata të njëjta sikurse edhe fatura e vjetër e energjisë elektrike. Për informata të detajizuara rreth leximit të faturës së re të energjisë elektrike luteni të vizitoni uebfaqen zyrtare të kompanisë www.keds-energy.com ose faqet e kompanisë në rrjete sociale.



 [kedsenergy](https://www.facebook.com/kedsenergy)

 [@kedsenergy](https://twitter.com/kedsenergy)